



DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE

***Ngritja e kapaciteteve për një
administratë tatimore
profesionale: Arritjet dhe Sfidat***



- **QELLIMI:**

- *Duke qenë pjesë e një mjedisi ekonomik mjaft dinamik, sfida kryesore e administratës tatimore është, realizimi në nivelet e duhura i mbledhjes së të ardhurave për Buxhetin e Shtetit, në të njëjtën kohë që plotëson pritshmëritë e tatimpaguesve të saj.*
- Kjo arrihet duke qenë partnerë profesionistë për tatimpaguesit, duke shërbyer me integritet, përkushtim, profesionalizëm, bashkëpunim, transparencë dhe etikë.

- **VIZIONI:**

- Arritja e krijimit të një administrate tatimore europiane në mbështetje të tatimpaguesve për rritjen e mirëqenies së tyre, duke luajtur plotësisht rolin tonë në proceset integruuese europiane.



- **Ngritja e kapaciteteve:**

- Padyshim në përpjekjet për të ngritur dhe përmirësuar vazhdimisht kapacitetet profesionale administrata tatimore është ndihmuar dhe mbështetur nga organet dhe institucionet kompetente për realizimin e këtij misioni sa të vështirë aq dhe të rëndësishëm.
- Konkretisht partnerët tanë për arritjen e këtij objekti janë si më poshtë:
 1. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (në vazhdim ASPA), themeluar në bazë të Ligjit Nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe
 2. Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore (në vazhdim QTATD), themeluar në bazë të Vendimit Nr.1264, datë, 16.12.2009 “Për krijimin dhe funksionimin e Qendrës së trajnimit të administratës tatimore dhe doganore.”



- **Qëllimi dhe funksionet e ASPA**

- ASPA si institucion me autonomi administrative dhe akademike, ka për qëllim formimin profesional të nëpunësve civilë, si dhe të çdo individ tjetër, vendas ose të huaj, që nuk është pjesë e shërbimit civil dhe që plotëson kriteret e kërkuara.
- ASPA ka për detyrë të ofrojë formimin profesional nëpërmjet, përfshirjes së programeve të mëposhtme:
 - a) programit të formimit të thelluar, në bazë të të cilit formohen kandidatët për anëtarë të TND-së;
 - b) programit të formimit të vazhdueshëm, në bazë të të cilit trajnohen në vazhdimësi dhe në lidhje me punën nëpunësit civilë të të gjitha kategorive, si dhe çdo individ tjetër jashtë këtij shërbimi



- **Objektivat dhe funksionet e QTATD.**

Kryesisht objektivat e QTATD janë si më poshtë:

- Edukimi fillestar e sistematik i punonjësve të administratës tatimore dhe doganore me qëllim arritjen e objektivave strategjike të përgjithshme qeverisëse dhe ato specifike të organeve fiskale në përputhje me rregullat dhe dispozitat ligjore.
- Hartimi i planit të trajnimeve në përputhje me objektivat qeverisës dhe nevojat e stafit të organeve tatimore dhe doganore.
- Përzgjedhja e temave të trajnimit në funksion të rritjes së kapaciteteve administrative të afta për të absorbuar reformat, për të kuptuar dhe zbatuar çdo ndryshim si në administrim ashtu dhe në teknikat ligjore.
- Akademia siguron formimin profesional të administratës tatimore dhe doganore, i cili përfshin trajnimin:
 - a) në periudhën e provës;
 - b) për zhvillimin e karrierës;
 - c) për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, sipas ligjeve të fushës;
 - ç) me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta;
 - d) për zhvillimin e njohurive profesionale.



- **Programi i trajnimit të Administratës Tatimore.**

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka hartuar strategjinë e trajnimit me fushat dhe grupet e synuara për trajnim për periudhën 2015 - 2016. Programi i Trajnimit për vitin 2016, ka të përcaktuar synimet, objektivat dhe strategjinë e realizimit të këtij programi.
- Për temat specifike të fushës fiskale, Administrata Tatimore ka të identifikuar trajnuesit e vet, të cilët janë përfshirë në procesin trajnues të deritanishëm dhe synohen të përfshihen edhe në të ardhmen.
- Kurikulat edhe materialet trajnuese të fushës fiskale janë ndërtuar bazuar mbi legjislacionin tatimor në fuqi, prej ekspertëve trajnues të fushave të synuara për trajnim në DPT dhe që janë të kualifikuar brënda kësaj organizate, në bashkëpunim edhe me asistencat e huaja të ofruara për trajnimin.



Arritjet për një administratë tatimore profesionale.

Gjatë periudhës tetor 2015- mars 2016 janë trajnuar 1904 punonjës:

- Në bashkëpunim me Akademinë Fiskale janë trajnuar në total 1475 punonjës të administratës tatimore, mbi çështje të ndryshme lidhur me implementimin e legjislacionit tatimor, mbi përdorimin e sistemit të ri të IT-së, mbi përdorimin dhe kontrollin e sistemit të paisjeve fiskale, etj.
- Në bashkëpunim me ASPA janë trajnuar gjithsej 347 punonjës, nga të cilët 53 punonjës të shërbimit civil në periudhë prove, duke kryer trajnim bazë, si dhe pjesa tjetër për çështje që lidhen me etikën në punë dhe organizimin e punës.
- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë realizuar trajnimet e 82 punonjësve, trajnime këto mbi Kodin e Etikës për punonjësit e Administratës Publike.



- **Asistenca nga institucionet ndërkombëtare.**
- *Titulli i projektit: “Thjeshtësimi dhe Transparenca Tatimore në Shqipëri”,*
- *Objektiva, qëllimi i projektit dhe komponentet e tij:* Thjeshtëzimin e procedurave tatimore me synim uljen e kostove për përmbushjen e detyrimeve tatimore, dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe efikasitetin e administratës tatimore për procedurat ndërkombëtare të taksimit duke i kushtuar vëmëndjen kryesore transferimit të çmimit.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjithashtu ka dërguar propozimet e saj në Ministrinë e Financave, me synim përfitimin nga asistenca financiare e BE për Shqipërinë që do të jepet në kuadër të **IPA II, IPA 2015; IPA 2016** duke u fokusuar në :
 - - Mbështetje për harmonizimin e legjislacionit, procedurave dhe praktikave në mënyrë që ato të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së.
 - - Mbështetje për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit

- **Disa risi të SKK-ve të ndryshuara në sistemin tatimor.**

Disa koncepte dhe nocione të qartësuara në Kuadrin e përgjithshëm dhe parimet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare, janë ndihmesë në punën e inspektorëve të kontrollit tatimor. Kështu p.sh përsa i përket SKK1 :

- Një objektiv më i gjerë i pasqyrave financiare dhe harmonizimi i tij me standartet ndërkombëtare të raportimit financiar(SNRF), do të lehtësojë përputhshmërinë e SKK me SNRF, gjë që do të thotë që të kemi një pamje më të plotë të transaksioneve të biznesit. Pamja më e plotë dhe e qartë e transaksioneve do të lehtësonte kontrollin dhe vlerësimin tatimor.
- SKK1 në përputhje më të plotë me SNRF, por dhe në pajtueshmëri me Kërkesat e Direktivave të Ligjit për Shoqëritë e Bashkimit European, do të thotë që për audituesin fiskal të jetë më e lehtë për të krahasuar pasqyrat dhe rezultatet financiare të tatimpaguesve rezidentë në Shqipëri, me tatimpagues rezidentë në vende të tjera të Evropës apo të botës, kur është e nevojshme.
- Është qartësuar fakti se zbatimi i nocionit zakonisht të njohur si “koncepti i përputhshmërisë”, nuk mund të rezultojë në krijimin e aktiveve ose detyrimeve nëse këto aktive dhe detyrime nuk plotësojnë përkufizimet e aktiveve dhe detyrimeve sipas SKK1. Kjo është e rëndësishme për të parandaluar manipulimin e fitimit dhe humbjes në pasqyrat financiare të përgatitura sipas SKK. Nga pikëpamja fiskale kjo do të thotë parandalim i zvogëlimit apo manipulimit të bazës së taksueshme, që do të thotë taksim më i saktë dhe i drejtë për tatimpaguesit.



- **Hapat e mëtejshëm:**
- *Rritja e profesionalizmit, sidomos përsa i përket aftësive të specializuara për auditimin e sektorëve të vecantë të ekonomisë si: tregti, ndërtim, institucione financiare, shërbime, etj.*
- *Rritja e ndërgjegjësimit të inspektorëve tatimorë për një njohje sa më të mirë të SKK-ve , si ndihmesë në punën e tyre.*
- *Përmirësimi i teknikave të auditimit përsa i përket kontrollit të shoqërive të mëdha dhe shoqërive ndërkombëtare.*
- *Përafrimi dhe zbatimi i praktikës më të mirë në auditimin dhe vlerësimin tatimor.*